

UNIVERSITETI “FEHMI AGANI” GJAKOVË

FAKULTETI I MJEKËSISË

PROGRAMI: MAMI



**EPIDEMIOLOGJIA E MENARKËS TE VAJZAT E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

PUNIM DIPLOME

Kandidatet:

Fjoralba Fetahaj

Edorina Hoda

Mentor:

Prof. Asist. Selami Sylejmani, MD, PhD

Nëntor, 2018

INFORMATA RRETH PUNIMIT

Punimi i temës:

"EPIDEMIOLOGJIA E MENARKËS TE VAJZAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS", i
kandidates **FJORALBA FETAHAJ** dhe **EDORINA HODA** u pranua në Fakultetin e Mjekësisë
në Universitetin " Fehmi Agani" në Gjakovë.

Mentor i këtij punimi është **Prof. Asist. SELAMI SYLEJMANI, MD, PhD.**

Punimi përfshinë 25 faqe.

DEKLARATA E KANDIDATES

Unë **FJORALBA FETAHAJ** dhe unë **EDORINA HODA** deklarojmë se, kjo temë e Diplomës, “ **EPIDEMIOLOGJIA E MENARKËS TE VAJZAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS** ”, i llojit të studimit: **RISHIKIM I LITERATURËS**, është punim i ynë origjinal.

E gjithë literatura dhe burimet tjera që i kam shfrytëzuar gjatë punimit janë të listuara në referenca dhe plotësisht të cituara.

I gjithë punimi është punuar dhe përgatit duke respektuar dhe mbështetur në këshillat dhe rregullorën për përgatitjen e temës së diplomës të përcaktuara nga ana e **Universitetit “Fehmi Agani” Gjakovë, Fakultetit të Mjekësisë.**

FALENDERIMET

I falenderojm të gjithë ata që na mbeshtetën.

Falenderojm stafin akademik të **Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”** në **Fakultetin e Mjekësisë** të cilët plot tre vite treguan korrektësi, gadishmeri dhe energji për ne studentët.

Falenderojm mentorin tonë, **Prof. Asist. Dr. Selami Sylejmani**, i cili gjatë mësimit na dhuroj njohuri të reja dhe na ndihmoj në përgaditjen e temës me korrektësi duke na dhënë këshilla dhe udhëzime të mirëfillta.

Në fund por jo të fundit falenderojmë familjen tonë për përkrahjen e pa kursyer gjatë gjithë shkollimit.

PARAGRAFI

Në mbështetje të Rregullores për studime themelore të Fakultetit të Mjekësisë neni 46 dhe të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë të datës 02.10.2017 nr. ref.005/ 368 deklarojmë se:

- **Pjesa e parë e temes së diplomes duke përfshirë hyrjen shtjellimin e teme, qëllimin janë punuar nga unë Edorina Hoda, ndërsa**
- **Pjesa e dytë e temes materiali dhe mtoda e punës, rezultatet, diskutimet e deri tek nxerrja e përfundimeve është punuar nga unë Fjoralba Fetahaj.**

PËRMBAJTJE

ABSTRAKTI	7
2. HYRJE	8
2.1. Anatomia dhe fiziologjia e organeve gjentiale femërore	8
2.2. Ovaret (vezorët)	8
2.3. Tubat uterine	8
2.4. Uterusi	9
2.5. Vagina	10
2.6. Periudhat e jetës së femrës krahasuar me aktivitetin e vezoreve	11
2.7. Periudha e pubertetit	11
2.7.1. Cikli menstrual	12
2.7.2. Menarka	14
3. QËLLIMI I PUNIMIT	15
4. METODOLOGJIA E PUNËS	16
5. REZULTATE	17
6. DISKUTIMI	19
7. PËRFUNDIMI	20
8. REZYME	21
9. REFERENCA	22
10. CV E KANDIDATEVE	23

ABSTRAKTI

Puberteti, ose siç njihet ndryshe mosha e pjekurisë seksuale, shoqërohet më ndryshime të shumta fizike dhe psikologjike tek njeriu. Studime të shumta kanë treguar se mosha e fëmijërisë sa vjen dhe shkurtohet, ndërsa puberteti nis gjithnjë e më herët duke shkaktuar një disbalancë mes zhvillimit fizik dhe atij mendor. Puberteti tek femrat, i nënkuptuar si shfaqja e menstruacioneve të para, ndodh me shpesh rreth moshës 12-13 vjeç. Menarka nuk është ngjarje finale e pubertetit. Ajo më shumë shënon fillimin e fazës së fundit të zhvillimit pubertal. Menstruacioni i parë, fillon në mes të moshës 11-13 vjeç. Kjo moshë ballafaqohet me sfida të mëdha prandaj nese do të kishte edukim të mjaftueshëm familjar, shoqërorë, broshura, edukim shkollorë, media, institucionet shëndetsore për ciklin menstrual atëherë këto do të jenë të përgatitur psikikisht dhe fizikisht.

Qëllimi i punimit është paraqitja e menarkes te vajzat e Republikës së Kosovës për periudhen 2008-2017, të gjendet mosha dhe mesatarja e menarkes. Kemi arritur në rezultate se për periudhen 2008-2017 kanë qenë 12.911 vajza, mesatarja e të cilave ka qenë 13 vjeç dhe mediana ka qenë 14 vjeç. Krahasuar me vendet e Shqipërisë së veriut kjo shifer mbetet e njejt dhe se edhe atje mesatarja e menarkes është 13 vjeç. Mosha e shfaqjes së menarkes në vendin tonë në Kosovë është mjaft stabile dhe se të dhënat nuk ndryshojnë shumë ndër vite.

2. HYRJE

2.1. Anatomia dhe fiziologjia e organeve gjenitale femërore

2.2. Ovaret (vezorët)

Ovaret (vezorët) janë qendra riprodhuese në formë bajame, të vendosura në afërsi të mureve pelvike laterale, në secilën anë të uterusit dhe që prodhojnë ovocite. Ovaret prodhojnë gjithashtu esterogjen dhe progesteron, hormone përgjegjëse për zhvillimin e tipeve seksuale dytësore dhe për rregullimin e shtatzënisë. Vezorët janë struktura rreth 3 deri në 4 cm. të gjata dhe janë të kapura tek ligamenti i gjerë.

Funksionet primare të vezorëve janë ovogjeneza dhe prodhimi i hormoneve. Vezorët, tubat e fallopit dhe ligamentet mbajtëse quhen adnekse. Pra, ovaret janë gjithashtu edhe qendra endokrine që prodhojnë hormone riprodhuese. Te femrat para pubertetit kapsula me ind lidhor (tunikaalbuginea e ovoarit) e cila përfshinë sipërfaqën e ovarit mbulohet nga një shtresë e lëmuar e mezotelit ovarian ose nga epiteli sipërfaqësorë (germinal), e cila është një shtresë teke me qeliza kuboide që i jep sipërfaqës një pamje të zbehtë ngjyrë gri në kontrast.

Pas pubertetit epiteli sipërfaqësorë ovarian në mënyrë përparuese bëhet cikatrikal dhe shtrembërohet, për shkak të rrupturës së përsëritur të folikujve ovarian dhe çlirimit të ovociteve gjatë ovulacionit. Enët e gjakut, enët limfatike dhe nervat e ovareve kryqëzojnë buzën pelvike duke kaluar në faqen superolaterale të ovarit dhe duke dalur nga kjo faqe, brenda shtresës peritoneale, që quhet ligament suspensor i ovarit, i cili vazhdon me mezovariumin e ligamentit të gjerë.

2.3. Tubat uterine

Tubat uterine, rreth 10 cm. të gjërë dhe me diametër rreth 1 cm, shtrihen anash duke filluar nga brirët e uterusit. Secili tub, me skajin e tij proksimal hapet në bririn e uterusit dhe me skajin e tij distal në kavitetin peritoneal. Tubat mbajnë ovocitet që vijnë nga ovaret dhe spermatozoidët që hyjnë nga uterusit, për të arritur në vendin e përfundimit, në ampluen e tubit uterin. Tubi uterin

drejton gjithashtu zigotën, nëndarje drejt kah vitetituterin. Për qëllim përshkrimi, tubi uterin ndahet në katër pjesë: infundibulum, ampulla, isthmus dhe pjesa uterine.

2.4. Uterusi

Uterusi është organ (nga lat. mitër) muskolor, kavitar me muret e trasha dhe në formë dardhe. Me gjatësi 7-8cm, gjerësi 5-7cm. Në pjesën e sipërme të saj edhe trashësitë e murit 2-3cm. Peshon afërsisht 90g. Uterusi përbëhet nga dy pjesë madhore: trupi (që përbënë 2/3 e sipërme) dhe qafa (që përbënë 1/3 e poshtme). Trupi i uterusit vjen duke u shtrënguar nga fundusi deri në isthmus. Qafa e uterusit përbënë skajin vaginal të mitrës që është i ngushtë dhe në formë afërsisht cilindrike. Lumeni i qafës, kanali cervical ka hapje të ngushtë në secilin skaj. Hapja e mbrendëshme komunikon me kavitetin e trupit uterin dhe hapja e jashtme komunikon me vagjinën. Muri i trupit të uterusit (mitrës) përbëhet nga tri shtresa:

- **Perimetrium, shtresa e hollë, shtresa e jashtme;**
- **Miometrium, shtresa e trashë e muskulaturës së lëmuar dhe**
- **Endometrium, shtresë e hollë, shtresë e mbrendshme.**

Embrioni dhe fetusi zhvillohen në uterus (mitër). Muret muskulare të uterusit përshtaten për rritjen e fetuesit dhe më pas e sigurojnë forcën për daljen e tij gjatë procesit të lindjes. Uteruesi jogravid (jo shtatzënë) zakonisht shtrihet në pelvisin e vogël, trupi i tij shtrihet mbi vezikën urinare dhe cerviksi i tij midis vezikës urinare dhe rektumit. Pra, përmasat dhe pjesët e tij e ndryshojnë gjatë ndryshimeve të ndryshme të jetës. Uteruesi i femrave të rritura zakonisht është i antervertuar (maja me drejtim anterio superior në lidhje me boshtin e vaginës) dhe i antefleksuar (i përlulur përpara në lidhjeje me cerviksin) dhe në këtë mënyrë trupi i tij shtrihet mbi vezikën urinare. Si rrjedhojë kur vezika urinare është e zbrazët, në mënyrë tipike, uterusit shtrihet në një plan pothuajse transversal. Pozicioni i uterusit ndryshon sipas shkallës së mbushjës së vezikës urinare dhe rektumit, si dhe të stadit të shtatzënisë.

2.5. Vagina

Vagina, e cila përbëhet nga një tub muskulo membranoz i gjatë 7-9 cm. shtrihet nga pjesa mediale e cerviksit të uterusit deri në orificiumin vaginal, që është hapja në skajin inferior të vaginës. Orificiumi vaginal, orificiumi uretral i jashtëm, si dhe duktuset e gjëndrave vestibulare të mëdha dhe të vogla hapën në vestibulin e vaginës, që është orificium midis labia minora. Skaji superior i vaginës rrethon cerviksin.

Vagina:

- Shërben si kanal për lëngun menstrual,
- Formon pjesën inferiore të kanalit të lindjës,
- Shërben për penetrimin e penisit dhe të lëngut spermatic gjatë marrëdhënjes seksuale dhe,
- Komunikon sipër me kanalin cervical dhe poshtë me vestibulin e vaginës.

Vagina zakonisht është e mbyllur. Vagina shtrihet prapa vezikës urinare dhe uretrës, ku kjo e fundit përkulet në murin e saj inferior anterior. Ajo gjendet përpara rektumit duke kaluar midis buzëve mediale të muskujve levatorani (puborektal). Forniksi vaginal i cili është recesi për rreth cerviksit përbëhet nga pjesa anterior-posterior dhe laterale. Forniksi vaginal posterior është pjesa më e hollë dhe lidhet më ngushtë me xhepin rektouterin. Pjesa më e madhe inervohet nga nervat viscerale.




Figura.1. Pamje nga organet gjendrore femërore

2.6. Periudhat e jetës së femrës krahasuar me aktivitetin e vezoreve

Gjithsej janë gjashtë periudha:

- Periudha infantile (deri në moshën 7- vjeçare)
- Periudha para pubertetit (8 deri në 10 vjeç)
- Periudha e pubertetit (10 deri në 14 vjeç)
- Periudha gjenerative (15 deri në 45 vjeç)
- Klimaksi, menopauza dhe postmenopauza (45 deri në moshën 60 vjeçare)
- Periudha e pleqërisë (nga mosha 60- vjeçare e deri në vdekje).

2.7. Periudha e pubertetit

Puberteti, ose siç njihet ndryshe mosha e pjekurisë seksuale, shoqërohet më ndryshime të shumta fizike dhe psikologjike tek njeriu. Nëse në të kaluarën puberteti dhe adoleshenca koïncidonin me njëra-tjetrën, sot nuk është më kështu. Studime të shumta kanë treguar se mosha e fëmijërisë sa vjen dhe shkurtohet, ndërsa puberteti nis gjithnjë e më herët duke shkaktuar një disbalancë mes zhvillimit fizik dhe atij mendorë. Puberteti tek femrat, i nënkuptuar si shfaqja e menstruacioneve të para, ndodh me shpesh rreth moshës 12-13 vjeç. Teoria e ndikimit të faktorëve raciale dhe klimaterike sot e ka humbur një pjesë të vlerës së saj. Më tepër i nëshohet faktorëve gjenetikë, statusi i shëndetit, lloji i ushqyerjes dhe kushteve social-ekonomike të ambientit. Në fakt, në familjet e mëdha dhe me probleme sociale, puberteti manifestohet më vonë. E kundërta ka ndodhur në vendet me përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të jetesës së popullsisë, ku në më pak se 100 vite vihet re një ulje e ndjeshme e moshës së shfaqjes së pubertetit prej 3-4 vitesh. Menstruacionet e para paraprihen nga shfaqja dhe modifikimi i shenjave seksuale sekondare. Shenja e parë është ngritja e aereolës së gjirit, zakonisht rreth moshës 10 vjeç. Kjo tregon për fillimin e prodhimit të estradiolit (hormoni kryesor femëror) nga ovari (vezorja). Më pas zhvillohen gjinjte, të cilët kanë formë e vëllim të ndryshëm, sipas racës, familjes, karakteristikave trupore, tipit të ushqimit, aktivitetit sportiv. Qimëzimi pubik shfaqet zakonisht disa muaj pas fillimit të zhvillimit të gjinjëve,

qimëzimi aksilar ndodh më vonë (1-2 vjet me vonë) dhe arrin stadin adult për 2-3 vjet. Ndryshime ndodhin edhe në gjenitalet e jashtme, në lidhje me modifikimin e formës, ngjyrës dhe konsistencës së tyre. Karakteristikë në këtë periudhë janë dhe disa sekrecione të pakta, të bardha, që janë shenjë e aktivitetit hormonal, pra krejt normale. Ardhja e menstruacioneve të para është momenti më domethënës për arritjen e pjekurisë femërore, zakonisht 2 vjet nga fillimi i zhvillimit të gjinjve. Vlen të përmendet se ciklet e para të menstruacioneve mund të jenë të parregullta, qoftë në intervalin mes tyre, qoftë në kohëzgjatje, apo në sasinë e gjakut të humbur. E gjitha kjo është krejt fiziologjike. Po kështu, në periudhën pubertale vihet re një rritje e dukshme strukturale, e cila ndërpritet pas rreth 4 vjetësh nga menarka.

2.7.1. Cikli menstrual

Me cikël menstrual nënkuptojmë periudhën kohore prej ditës së parë të gjakderdhjes menstruale, e deri në shfaqjen e ardhme të menstruacionit. Menstruacioni është manifestimi i dukshëm i gjakderdhjes ciklike fiziologjike nga mitra, e cila shkaktohet për shkak të zhveshjes së endometrit që vjen si rezultat i bashkëveprimit të hormoneve, kryesisht të boshtit hipotalamo-hipofizo-ovarial. Që të ndodh menstruacioni, ky bosht duhet të jetë i koordinuar në mënyrë aktive, endometri duhet të jetë i përgjegjshëm ndaj hormoneve të vezorës (esterogjeneve dhe progesteronit) dhe trakti rrjedhës duhet të jetë i kalushëm. **Menstruacioni i parë (menarke) shfaqet në moshën 12-14 vjeçare dhe në shfaqjen e tij ndikojnë shumë faktorë, siç janë: klima, ushqimi, sëmundjet etj.**

Menstruacioni i vërtetë është gjakderdhje nga endometri i proliferuar nën ndikimin e hormoneve endogjene. Prandaj çdo gjakderdhje periodike nga mitra nuk është menstruacion, edhe nëse për kah intensiteti, kohëzgjatja dhe ritmi i përngjanë menstruacionit të vërtetë. Menstruacionit të vërtetë i paraprinë gjithmonë ovulimi dhe formimi i trupit të verdhë.

Menstruacionet normale karakterizohen me kohëzgjatjen, intensitetin dhe ritmin e tyre. Sipas kohëzgjatjes, menstruacionet normale konsiderohen menstruacionet të cilat zgjasin mesatarisht 3-5 ditë, kurse menstruacionet jonormale konsiderohen menstruacionet që zgjasin më tepër se 7 ditë. Intensiteti i gjakderdhjes ditën e parë është minimal, ditën e dytë dhe të tretë diç më i theksuar,

kurse ditën e katërt dhe të pestë ndërpriten komplet. Sasia mesatare e humbjes së gjakut gjatë ciklit normal menstrual është rreth 30-80 ml. Pothuajse tri të katërtat e kësaj sasive të gjakut humbet gjatë dy ditëve të para të menstruacioneve. Femrat të cilat janë nën moshën 35-vjeçare kanë tendencë të humbin më shumë gjak gjatë menstruacioneve sesa ato që kanë moshë më të madhe se 35 vjeç. Tajitja menstruale përmban normalisht gjak, qeliza epiteliale endometriale dhe vagjinale të deskuamuara, mukus cervical dhe baktere. Cikli menstrual zgjatë rreth 28 ditë, mirëpo intervalet 24 deri 32 ditë konsiderohen normale, nëse ciklet nuk kanë çrregullime të mëdha. Në fillim dhe në fund të moshës riprodhuese cikli menstrual manifeston me shumë çrregullime dhe është më i paparashikueshem për shkak të mungesës së ovulacionit.

Cikli menstrual manifestohet me ndryshime ciklike në tërë traktin riprodhues të femrës, si në: vezore, endometër, qafë të mitrës, vepërques, vagjinë, e gjithashtu edhe në organet jashtëgjinore, siç janë: gjinjë, gjëndrat e tjera endokrine, qendra termorregulluese e hipotalamusit etj. Prej tyre, ndryshimet në endocerviks dhe në gjinjë mund të shihen drejtpërdrejt, ndryshimet në qëndren termorregulluese të hipotalamusit mund të konstatohen duke e matur temperaturë bazale, kurse ndryshimet në vagjinë dhe në endometër mund të vlerësohen me ekzaminim histologjik, përmes biopsis.

2.7.2. Menarka

Menarka nuk është ngjarje finale e pubertetit. Ajo më shumë shënon fillimin e fazës së fundit të zhvillimit pubertal. Aspekti më i rëndësishëm i të gjithë këtij procesi është vazhdimi i stimulimit të folikulave ovariale, ndërsa përfundimisht vjen ovulacioni, që tregon dhe maturimin e sistemit hormonal. Duhet afërsisht 20 cikle përpara këtij funksioni të fundit të rëndësishëm që ovaret të fillojnë të funksionojnë rregullisht.

Menstruacioni i parë, i cili fillon në mes të moshës 11-13 vjeç femra duhet të jenë të përgatitura që t'i presin këto ndodhi zhvilluese. Mirëpo ndodh menstruacioni të jetë një ekspriencë e frikshme, për vajzat të cilat nuk e kuptojnë duke ndodhur kjo shoqërohet me ndryshime të mëdha psiqike. Prandaj edukimi paraprak rreth paraqitjes së ciklit menstrual ndikon mjaft te adoleshenca. Kjo moshë ballafaqohen me sfida të mëdha prandaj nëse do të kishte edukim të mjaftueshëm familjarë, shoqërorë, broshura, edukim shkollorë, media, institucionet shëndetësore për ciklin menstrual atëherë këto do të jenë të përgatitur psiqikisht dhe fizikisht.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

- Qëllimi kryesor i punimit është paraqitja e menarkes në vendin tonë për 10 vitet e fundit nga 2008 – 2017.
- Qëllim tjetër është edhe shfaqja e moshës së menarkes tek vajzat në Kosovë dhe gjetja e mesatares aritmetike si dhe medianes.

4. METODOLOGJIA E PUNËS

Materiali dhe metoda e punës është studim apo hulumtim shkencorë. Janë marrë të dhënat nga regjistrat dhe janë shfaqur më poshtë nëpërmes tabelave dhe grafikoneve.


Gjithashtu tek pjesa e rishikimit të literatures, shënimet dhe të dhënat janë marrë nga biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Gjakovës.

5. REZULTATE

Tabela.1. Paraqitja e numrit të përgjithshëm të vajzave në vendin tonë Kosovë nga periudha 2008 – 2017 si dhe ndarja e tyre sipas grupmoshave të shfaqjes së menarkes.

Mosha e shfaqjes së menarkës	Numri	Përqindja %
9 vjeç	12	0.09
10 vjeç	49	0.38
11 vjeç	388	3.01
12 vjeç	1901	14.72
13 vjeç	3093	23.96
14 vjeç	3846	29.79
15 vjeç	2254	17.46
16 vjeç	858	6.65
17 vjeç	352	2.73
18 vjeç	129	1.00
19 vjeç	19	0.15
20 vjeç	7	0.05
22 vjeç	3	0.02
Gjithsej	12.911	100.0%

Grafikoni.1. Paraqitja e numrit të përgjithshëm të vajzave në vendin tonë Kosovë nga periudha 2008 – 2017 si dhe ndarja e tyre sipas grupmoshave të shfaqjes së menarkes.



6. DISKUTIMI

Menarka konsiderohet nga shumica e autorëve si shenjë e sigurtë e arritjes së pjekurisë seksuale tek vajzat. Të dhënat e një punimi të realizuar, i këtij lloji sikurse tek ne, në vitet 1987-1998 në disa prej qyteteve të Shqipërisë së Veriut. Mostra ishte 1806 vajza të ndara në 15 grup-mosha. Mosha mesatare e menarkës është përcaktuar mosha 13 vjeç. Fillimi i cikleve menstruale 95% mendohet të nisë dikund mes viteve 10 dhe 16 vjeç, ndërsa 99% të tyre midis moshës 9 dhe 17 vjeç.

Nga të gjitha vajzat e mostrës, 68% e kanë menarken. Mosha më e vogël e menarkës rezulton të jetë 8 vjeç. Para moshës akute 10 vjeçare, asnjë vajzë nuk rezulton me menarke, para asaj akute 11 vjeç, dikund 2% e grup-moshës dhe para moshës 12 vjeç diku 11.9% e grup-moshave. Ndërkohë, para moshës 16 vjeç rezoltojnë 2.5% apo 4 vajza pa menarkë.

Vajzat me moshën akute më të madhe pa menarke është ajo me moshë 17 vjeç.

7. PËRFUNDIMI

- Moshë e shfaqjes së menarkes në vendin tonë në Kosovë është mjaft stabile dhe se të dhënat nuk ndryshojnë shumë ndër vite,
- Nga periudha apo nga viti 2008 e deri tek viti 2017 janë regjistruar 12.911 paciente vajza me menarkë,
- Moshë mesatare e pacienteve vajza me menarkë sillet diku 13 vjeç,
- Mediana e këtyre pacienteve vajza me menarkë është 14 vjeç.

8. REZYME

Puberty, or otherwise known as the age of sexual maturity, is accompanied by numerous physical and psychological changes in humans. Numerous studies have shown that childhood ages and shortens puberty ever before, causing a disbalance between physical and mental development. Puberty in women, implied as the appearance of first menstruation, occurs more often around the age of 12 to 13 years. Menarque is not the final event of puberty. It marks the beginning of the last phase of puberty development. The first menstruation starts between 11-13 years of age. This age faces great challenges, so if there are sufficient family, social, brochure, school education, media, health care institutions for the menstrual cycle then they will be prepared psychologically and physically.

The purpose of the paper is to present the menarques to the daughters of the Republic of Kosovo for the period 2008-2017, to find the age and average of the menarques. We have come to the conclusion that for the period 2008-2017 there were 12,911 girls, the average of which was 13 and the media were 14 years old. Compared to northern Albania, this figure remains the same and the average of menarke is 13 years old. The age of the emergence of the menarke in our country in Kosovo is quite stable and the data does not change much over.

9. REFERENCA

1. Gjinekologjia, Fehmi Ahmeti- botimi i dytë i përpunuar, Prishtinë 2016.
2. Rakel, Robert E. Traktati i Mjekësisë së Familjës. [ed.] Julinda Jaho, Elona Stafuka, Mimoza Gjika Gentian Vyshko.
3. Anderson SE, Dallal GE and Must A (2003) Relative Weight and Race Influence Average Age at Menarche: Results from Two Nationally Representative Surveys of US Girls Studied 25 Years apart. *Pediatrics* 111, 844-50.
4. Bini V, Celi F, Berioli MG, Bacosi ML, Stella P, Giglio P, Tosti L and Falorni A (2000) BMI in Children and Adolescents According to Age and Pubertal Stage. *Eur. J. Clin. Nutr.* 54 (3), 214-8.
5. Bliss CI (1935) The calculation of the DosageMortality Curve. *Annals of Applied Biology* 22, 138-140.
6. Ersoy B, Balkan C, Gunay T and Egemen A (2005) Effects of Different Socio-economic Conditions on menarche in Turkish Female Students. *Child Care Health Dev.* 31 (3), 303
7. Freedman DS (2002) Relation of Age at Menarche to Race, Time Period and Anthropometric Dimensions. *Pediatrics* 110 (4), 43.
8. Fredriks AM, van Buuren S, Jeurissen SE, Dekker FW, Verloove – Vanhorick SP and Wit JM (2004) Height, Weight, BMI and Pubertal Development References for Children of Moroccan Origin in the Netherlands. *Acta Paediatr.* 93 (6), 817-24.
9. Gun RI, Möller M and Gunarsson RK (2006) Attitudes and Feelings towards Menstruations and Womanhood in Girls at Menarche. *Acta Paediatrica*, 95, 6, 707 – 14.
10. Hesketh T, Ding QJ and Tomkins A (2002) Growth Status and Menarche in Urban and Rural China. *Annals of Hum. Biol.* 29, 348-52.
11. Kobzova J, Vignerona J, Blaha P, Krejcovsky L and Riedlova J (2004) The 6th Nationwide Anthropological Survey of Children and Adolescents in the Czech Republic in 2001. *Cent. Eur. J. Public Health*, 12 (3), 126

10. CV E KANDIDATEVE

Të dhëna personale	
1.Mbiemri	Hoda
2.Emri	Edorina
3.Nacionaliteti	Shqiptare
4.Shtetësia	Kosovare
5.Data e lindjës	06.10.1995
6. Gjinia	Femër
7.Numri Personal	1235141759
Të dhënat kontaktuese	
Telefoni:	+38343 992 669
Adresa:	Mithat Frashëri , Gjakovë
Emaili:	edorina.hoda@outlook.com
Të dhënat e kualifikimit	
Shkolla e Mesme e Lartë	Shkolla e Mesme e Mjekësisë – Gjakovë
	"Asistente e Pediatriisë "
Universiteti	Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"
Fakulteti	Fakulteti i Mjekësisë
Programi	Mami
Statusi	E rregullt
Nr.ID- së	150305012

Të dhëna personale	
1.Mbiemri	Fetahaj
2.Emri	Fjoralba
3.Nacionaliteti	Shqiptare
4.Shtetësia	Kosovare
5.Data e lindjës	22.10.1995
6. Gjinia	Femër
7.Numri Personal	1242040577
Të dhënat kontaktuese	
Telefoni:	+38344 854 183
Adresa:	Skivjan, Gjakovë
Emaili:	fjoralba.fetahaj@gmail.com
Të dhënat e kualifikimit	
Shkolla e Mesme e Lartë	Shkolla e Mesme e Mjeksësisë – Gjakovë
	"Asistente e Infermier i Pediatriisë "
Universiteti	Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"
Fakulteti	Fakulteti i Mjekësisë
Programi	Mami
Statusi	E rregullt
Nr.ID- së	150305023